



**AGJENCIA E SHËRBIMEVE
TË NAVIGACIONIT AJROR**

**RAPORTI VJETOR
2019**

AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

Adresa: Vrellë, Lypjan, 10070, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 59 58 100

Email: info.ashna@rks-gov.net

Uebfaqe: www.ashna-ks.org



Përmbajtja

STATISTIKA 2019	5
PARATHËNIE	6
PROFILI I ASHNA.....	8
Historiku	8
Roli i ASHNA.....	8
Misioni	10
Vizioni	11
Shërbimi i Kontrollit të Trafikut Ajror (KTA) - DATS.....	12
Shërbimi i Komunikimit, Navigimit dhe Vëzhgimit (KNV) - DTEK.....	13
Shërbimi i Informatave Aeronautike (SHIA) - DAIS	14
Shërbimi Meteorologjik (MET) - DMET	15
HAPËSIRA AJRORE E KOSOVËS.....	16
Hapësira e ulët ajrore e Kosovës	17
Hapësira e lartë ajrore e Kosovës	18
Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës	19
KONSUMATORËT DHE PARTNERËT.....	22
Bashkëpunimi me konsumatorët.....	22
Konsumatorët kryesor	24
Partnerët kryesor	25
Partnerët ndërkombëtarë	25
ASHNA DHE ALBCONTROL – MEMORANDUM MIRËKUPTIMI	26
STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	29
PUBLIKIMI I INFORMATAVE AERONAUTIKE – RKS.....	30
MONITORIMI PERFORMANCËS	32
Shërbimet terminale	38
Njësitë e shërbimit.....	39
Tarifimi.....	39
Tarifa njësi	39
Treguesit e performancës.....	40
SIGURIA.....	41
Caqet dhe treguesit kyç të performancës së Sigurisë për vitin 2019.....	43

OPERIMET	47
Operimet komerciale.....	48
Operimet Ushtarake	49
Operimet VFR	50
Operimet e gjithmbarshme	51
Vizitat zyrtare	28
KOMUNIKIMI, NAVIGACIONI DHE VËZHGIMI.....	53
METEO.....	67
PERSONELI	71
TRAJNIMET.....	74
MALLRA, SHËRBIME DHE PUNË.....	81
FINANCA.....	85
RREZIQET.....	105
AUDITIMI	107
PËRGJEGJËSIA SOCIALE	112

STATISTIKA 2019

Pasqyra e performancës operative

Operime komerciale	18,198
Operime ushtarake	1,101
Operime tjera (VFR)	2,331

21,630
operime





PARATHËNIE

Të dashur miq,

Kam kënaqësinë e veçantë të ju paraqes Raportin vjetor të ASHNA-së për vitin 2019, i cili përfshin informata rreth aktiviteteve, sfidave por edhe sukseseve përgjatë vitit kalendarik.

ASHNA gjatë vitit 2019, ka arritur përmbushjen e objektivave vjetore duke ofruar shërbime cilësore të navigimit ajror në hapësirën e Republikës së Kosovës, në kushtet e parrezikshmërisë, cilësisë, kujdesit ndaj mjedisit dhe i orientuar ndaj klientit.

Duke e konsideruar si një vit të suksesshëm vitin 2019, më lejoni që këtë sukses të ia dedikoj personelit të ASHNA-së dhe partnerëve tonë. Suksemi i ASHNA-së është real, duke konsistuar në rritjen e numrit të operimeve, rrjedhimisht edhe të hyrave.

Krahas sukseseve, viti 2019 ishte edhe sfidues duke pas parasysh objektivat vjetore dhe synimet e organizatës tonë, me theks të veçantë:

- normalizimi i hapësirës së ulët ajrore, përmes së cilës synojmë shkurtimin e distancës që fluturaket duhet të përshkojnë për të shfrytëzuar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës; dhe
- investimet në zhvillimin e sistemeve teknike dhe kadrovike në ASHNA.

Krahas sfidave, ASHNA ka performuar në mënyrën më të mirë të mundshme duke ofruar shërbime të cilësisë së lartë dhe duke garantuar siguri ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve të saj.

Duke njohur rëndësinë e punës sonë, ASHNA ka ruajtur performancën e burimeve njerëzore, duke ngritur kapacitetet si asnjëherë më parë – përmes programeve trajnuese, të përqëndruara në ngritjen e gjithmbarshme të zhvillimit të tyre në aspektin operativ, administrativ dhe të sigurisë.

Sinqerisht,

z. Bahri Nuredini

Drejtor

Ndër prioritetet e ASHNA-së për vitin 2019, ishte ngritja e kapaciteteve profesionale njerëzore në aspektin operativ dhe atë të sigurisë.



PROFILI I ASHNA

Historiku

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror është themeluar me Ligjin Nr.04/L-250, miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 20.03.2014, shpallur me dekretin Nr. DL-010-2014, datë 07.04.2014 nga Presidentja e Republikës së Kosovës - Atifete Jahjaga, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 28.04.2014 dhe hyrë në fuqi 15 ditë më vonë, gjegjësisht më 14.05.2014.

Me fillimin e aplikimit të këtij ligji në fuqi që nga 01.01.2016, ASHNA ka filluar t'u ofrojë të gjithë shfrytëzuesve, shërbimet e navigacionit ajror civil të cilat deri para hyrjes në fuqi të këtij ligji i ofronte Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"- Kontrolli Ajror.

Roli i ASHNA

ASHNA ofron shërbime të navigimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës


Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) të Republikës së Kosovës, ASHNA është e përkushtuar për operimin e sigurt të sistemit të navigimit ajror të Republikës së Kosovës. ASHNA do të veprojë në pajtim me politikat, legjislacionin, standardet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme për aviacionin civil në Republikën e Kosovës si dhe në përputhje me standardet dhe praktikën e rekomanduara të ONAC mbi shërbimet e navigimit ajror. AAC mund të nxjerrë procedura apo rregulla shtesë.

ASHNA është organizatë e pavarur buxhetore dhe autoritet publik me buxhet të vetin që administrohet në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës. ASHNA funksionon dhe organizohet e ndarë prej AAC-së. ASHNA ka kapacitet të plotë juridik dhe vepron si një ofrues i shërbimeve jo-fitimprurës, i cili mbulon shpenzimet dhe bazohet në performancë.

Duke ditur specifikat e veçanta të Kosovës dhe faktit që KFOR, përkatësisht Komandati i kësaj organizate vazhdon të mbajë kontrollin mbi Hapësirën Ajror të Kosovës, ASHNA ka nënshkruar një marrëveshje me KFOR (Procedurat e Përbashkëta të Operimit – ang. Joint Operation Procedures) përmes të cilës ASHNA ka funksionin e alertimit në rast të shkeljes së pautorizuar të hapësirës ajrore të Kosovës, të cilën e kontrollojnë.

Aktivitetet kryesore të ASHNA-së

- Kontrollin e Trafikut Ajror (KTA);
- Komunikimin, Navigacionin dhe Vëzhgimin (KNV);
- Shërbimin e Informatave Aeronautike (SHIA);
- Shërbimin Meteorologjik (MET); dhe
- Alertimi i shkeljes së pautorizuar të hapësirës ajrore të Kosovës që ASHNA e kontrollon.




Misioni

Normalizimi dhe ofrimi i sigurtë i shërbimeve të navigimit ajror për shfrytëzuesit e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës

Gjatë ushtrimit të përgjegjësiave dhe zbatimit të detyrave të saj, nga ASHNA kërkohet që në vazhdimësi të ofrojë shërbime të sigurta të navigimit ajror. ASHNA ofron shërbime të navigimit ajror duke iu nënshtruar kërkesave të legjislacionit në fuqi mbi Aviacionin Civil të Kosovës.

ASHNA vazhdimisht do të bëjë përpjekje për të zbatuar një kornizë të menaxhimit të trafikut ajror e cila është e bazuar në standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) dhe përqendrohet në përmirësimin e performancës së sigurisë, duke minimizuar ndikimin negativ ndaj mjedisit, duke ngritur kapacitetet që janë në përputhje me kërkesat e trafikut ajror, si dhe duke optimizuar efikasitetin e fluturimit dhe duke përmirësuar efikasitetin e kostos.



Vizioni

ASHNA do të jetë konkurrese në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror me efikasitetin më të lartë të kostos në rajon

Do të vazhdojmë të zhvillohemi si dhe të krijojmë një pozitë të fuqishme tek klientët dhe partnerët tonë duke marrë parasysh kërkesat e tyre gjatë ofrimit të shërbimeve tona. Ne do të arrijmë ambiciet tona përmes punonjësve të motivuar dhe të përkushtuar të cilëve do t'iu ofrojmë një mjedis pune ku ata do të kenë vazhdimisht mundësi për zhvillim profesional, gjë që do të krijojë bazën për vende pune atraktive për të gjithë punonjësit tonë.

Ngritja eventuale e nivelit të trafikut ndërkombëtar për dhe në Kosovë do të ketë ndikim pozitiv të gjithëmbarshtëm në ekonominë e vendit. Detyra kryesore e ASHNA do të jetë zbatimi i kërkesave ligjore në fushën e aviacionit civil gjë që kërkon investime të vazhdueshme në fushat siç vijon:

- Zhvillimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore;
- Investimet infrastrukturore;
- Teknologjitë dhe procedurat e reja për të përmirësuar efikasitetin operativ.


Ekzistojnë kërkesa të vazhdueshme për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm për të arritur nivelin e duhur të zhvillimit të infrastrukturës. Për më tepër, ASHNA parasheh që të investojë në zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për të menaxhuar edhe hapësirën e lartë ajrore të Kosovës kur një gjë e tillë të kërkohej nga ne.



Shërbimi i Kontrollit të Trafikut Ajror (KTA) - DATS

Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror është shërbim që ofrohet nga zyrtarë të licencuar të KTA-së me qëllim të:

- Evitimit të përplasjeve:
 - mes fluturakeve
 - në hapësirën manovruese, mes fluturakeve dhe pengesave;
- Përsheptimit dhe mbajtjes së rregullt të rrjedhës së trafikut ajror;
- Të ofrojë këshilla dhe informata që janë të nevojshme për zhvillim të sigurt dhe efikas të fluturimeve; si dhe
- Të njoftojë organizatat e caktuara në lidhje me fluturakët që kanë nevojë për kërkim e shpëtim, si dhe t'i ndihmojë ato organizata sipas nevojës.



Shërbimi i Komunikimit, Navigimit dhe Vëzhgimit (KNV) - DTEK

Shërbimi i komunikimit, navigimit dhe vëzhgimit është shtylla teknike e sistemit të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA). Ky shërbim përkujdeset për planifikimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve teknike që përdoren nga ASHNA për ofrimin e shërbimeve të kontrollit të trafikut ajror.

Shërbimi i komunikimit është përgjegjës për sistemet komunikuese të zërit dhe të dhënave që përdoren për komunikim tokë-ajër mes pilotëve dhe KTA-ve dhe për komunikim midis njësive të KTA-së dhe personave tjerë relevantë. Shërbimi i komunikimit është përgjegjës edhe për sistemet e vrojtimit dhe parashikimit që përdoren nga Departamenti Meteorologjik.

Shërbimi i navigimit është përgjegjës për pajisjet naviguese të instaluar në tokë, të cilat mundësojnë navigimin efikas dhe të sigurt të fluturakeve në ajër. Këto pajisje vazhdimisht transmetojnë radio sinjale që ndihmojnë fluturaket të përcaktojnë pozitën e tyre në hapësirë, pavarësisht kushteve meteorologjike.


Shërbimi i vëzhgimit është përgjegjës për sistemet e vëzhgimit, të cilat i ofrojnë KTA-së pamje të fluturakeve në hapësirën nën përgjegjësi.



Shërbimi i Informatave Aeronautike (SHIA) - DAIS

Qëllimi i shërbimit të informatave aeronautike është të sigurojë rrjedhën e informatave/të dhënave aeronautike të nevojshme për sigurinë, rendin, ekonominë dhe efikasitetin e navigacionit ajror ndërkombëtar. SHIA është përgjegjës për mbledhjen/sistemimin, redaktimin, formatimin, publikimin dhe distribuimin e të dhënave aeronautike të pilotët, njësitë KTA dhe palët tjera relevante. Të dhënat aeronautike, varësisht nga natyra e informatës, publikohen dhe distribuohen nëpërmjet këtyre dokumenteve kyçe:

- Publikimit të Informatave Aeronautike (AIP)
- NOTAM-ëve
- Qarkoreve të Informatave Aeronautike (AIC)
- Buletineve Informative të Para-Fluturimit (PIB)
- Mbledhja e statistikave të fluturimeve të realizuara.



Shërbimi Meteorologjik (MET) - DMET

Shërbimi meteorologjik u ofron informata mbi kushtet meteorologjike përdoruesve të hapësirës ajrore, njësive KTA dhe palëve tjera relevante. Ky shërbim ofron raporte vëzhguese të motit, siç janë METAR, SPECI, etj., dhe raporte parashikuese të motit, siç janë TAF (Terminal Aerodrome Forecast), TREND – Parashikime afatshurtëra, Parashikimi i Tërthortë ditor, Parashikimi 3 ditorë, Parashikimi 7 ditorë dhe Paralajmërimet e motit aeroportuale dhe ato ndaj misionit të KFOR-it. Departamenti Meteorologjik gjithashtu ofron paralajmërimet dhe informata tjera të rëndësishme meteorologjike në lidhje me kushtet klimatike që mund të ndikojnë fluturaket në ajër dhe tokë, ndërtesat dhe pajisjet e aeroportëve, shërbimet e aeroportëve dhe fluturaket në pistë.



HAPËSIRA AJRORE E KOSOVËS

10,908 km²

Hapësira ajrore e Kosovës që nga shtatori i vitit 1999 është pjesë e “Hapësirës së Përbashkët Operacionale të Ballkanit – JOA” të NATO-s, nën kontrollin operacional të Qendrës së Kontrollit të

Operimeve të Kombinuara Ajrore 5 (Combined Air Operations Control 5 - CAOC5), e cila në vitin 2014 është transferuar te Qendra Torrejon e Operimeve të Kombinuara Ajrore (Combined Air Operation Centre Torrejon CAOC TJ). Kjo hapësirë ajrore është hapësirë e kontrolluar, në të cilën ofrohen shërbime të trafikut ajror.

Në bazë të marrëveshjes në mes të NATO/KFOR-it dhe Hungarisë, hapësira e lartë ajrore e Kosovës (mbi nivelin e fluturimit 205, që i bie 6248 m mbi nivelin e detit) që nga prilli i viti 2014 për një periudhë fillestare pesëvjeçare do të menaxhohet nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë, HungaroControl, i cili bën kontrollimin e aeroplanëve që e mbikalojnë këtë hapësirë.

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës (nën nivelin e fluturimit 205) menaxhohet-kontrollohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, e cila ofron shërbime të navigacionit ajror për aeroplanët civilë gjatë fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës me qëllim të aterritit dhe ngritjes nga Aeroporti i Prishtinës. Gjithashtu, shërbime ofrohen edhe për fluturimet e KFOR-it, dhe fluturimet e aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të vendit. Hapësira e ulët ajrore është e klasifikuar si hapësirë e klasit D dhe F, në përputhje me dispozitat mbi klasifikimin e hapësirës ajrore nga Aneksi 11 i ICAO-s. Në figurat e mëposhtme janë paraqitur strukturat aktuale të hapësirës ajrore të Kosovës (hapësira e ulët dhe e lartë).


Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Neni 2, Paragrafi 2.1

“Kosova ka sovranitet të plotë, ekskluziv dhe të paprekshëm në hapësirën ajrore mbi territorin e saj dhe ka autoritet ekskluziv për organizimin dhe rregullimin e aktiviteteve të aviacionit civil në territorin dhe hapësirën ajrore të saj”.



Hapësira e ulët ajrore e Kosovës

Në hapësirën e ulët ajrore, aktualisht janë vetëm 2 korridore (shih figurën më poshtë) që përdoren për trafik komercial për vajtje-ardhje nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”. Këto janë XAXAN dhe SARAX në pjesën jugore të Kosovës në drejtim të Maqedonisë. Gjatë vitit 2019, në kuadër të takimeve për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (BANM), kanë vazhduar bisedimet për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore dhe hapjen e korridoreve ajrore me të gjitha shtetet fqinje të Kosovës. Më shumë detaje mbi këtë temë janë dhënë më poshtë.




**Struktura e hapësirës së ulët
ajrore në Republikën e Kosovës**

Hapësira e lartë ajrore e Kosovës

Struktura e hapësirës së lartë ajrore përbëhet nga 2 sektorë (shih figurat 2 dhe 3) nga niveli i fluturimit FL205 (6 km) deri në FL285 (9 km) dhe nga niveli i fluturimit FL285 (9 km) deri në nivelin e fluturimit FL660 (20 km). Sipas marrëveshjes në mes NATO-s dhe Hungarisë, kontrata fillestare për ofrim të shërbimeve në Hapësirën e Lartë Ajrore të Kosovës ka vazhduar për afat të pacaktuar që prej 3 tetorit 2018.


Sektori 1 (FL205 deri në FL285) përbëhet nga 4 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon nga pika hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon nga pika hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
3. Korridori L608, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR.



Sektori 2 (FL285 deri në FL660) përbëhet nga 5 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon nga pika hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon nga pika hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
3. Korridori L608, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR;
5. Korridori UL603, i cili fillon nga pika hyrëse VABEK dhe përfundon në pikën dalëse OLOTA.



Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës

Hapësira e ulët ajrore e Republikës së Kosovës shtrihet nga toka deri në lartësi 6,248 metra mbi nivel të detit. Kjo hapësirë kontrollohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror e Kosovës, nën mbikëqyrjen rregullore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. Shërbimet në këtë hapësirë përfshijnë të gjitha fluturimet për në dhe nga ANP “Adem Jashari”, fluturimet ushtarake të KFOR-it në Kosovë dhe fluturimet e aviacionit të përgjithshëm.

Që nga përfundimi i luftës, fluturimet civile mund të hyjnë dhe dalin nga Kosova vetëm përmes korridorit ajror që e lidhin vendin tonë me Maqedoninë. ASHNA ka bërë një studim se sa është ndikimi i mungesës së normalizimit të hapësirës ajrore të Kosovës. Duke marrë si shembull fluturimin në mes Budapestit dhe Prishtinës, përkatësisht Shkupit si referencë, ka dalë që Prishtina vetëm për shkak të shpenzimeve shtesë të karburantit, ka qenë 100 milion euro më e shtrenjtë si destinim për kompanitë ajrore, në krahasim me Shkupin. Poashtu, ndikimi mjedisor është i madh, ku sipas studimit del që janë emituar rreth 1 milion ton CO2 më shumë se sa është dashur, në rast që hapësira ajrore do të ishte e normalizuar.

	Shkup	Prishtine
Largesia	344 NM	301 NM
Largesia e fluturimit	390 NM	487 NM
Diferenca ne milje nautike	54 NM	186 NM
% e largesise shtese	13.37%	61.79%
Distanca optimale sipas parametrave te fluturimeve per ne Shkup	n/a	341 NM
Δ ne mes largesise aktuale te fluturimit dhe asaj optimale	n/a	145.75 NM
Δ ne mes largesise aktuale te fluturimit dhe asaj optimale (ne %)	n/a	42.71%
Minuta shtese te fluturuar	n/a	24.29 min
Litra karburant shtese per fluturim	n/a	540.85 l
Litra shtese ne vit (4 fluturime/jave)	n/a	108 169 l
Shpenzime shtese vetem per karburant ne vit (200 fluturime/vit)	n/a	48 647 Euro
Emitim shtese i CO2 per fluturim	n/a	2560 kg
Emitim shtese i CO2 per fluturim (200 fluturime/vit)	n/a	512 116 kg
Ekstrapolim i rastit studimor te fluturimit te Wizzair ne rreth 20 000 fluturime/vit		
Shpenzime shtese per karburant ne vit	n/a	4 864 773 Euro
Emitim shtese i CO2 ne vit	n/a	51 211 Ton
Ekstrapolim i rastit studimor te fluturimit te Wizzair ne 19 vjet operime te Aeroportit te Prishtines		
Shpenzime shtese per karburant (19 vjet)	n/a	92 430 687 Euro
Emitim shtese i CO2 (19 vjet)	n/a	973 000 Ton

Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, ndër të tjera, do të përfshinte hapjen e korridoreve të reja ajrore midis Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendeve fqinje (Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë), që do të shërbenin për të gjithë avionët që fluturojnë në ANP “Adem Jashari”. Korridoret e reja ajrore do ta shkurtonin kohën e fluturimit për rreth 20-25 minuta, do ta ulnin koston e operimit për kompanitë ajrore, që rrjedhimisht, do të duhej të reflektohej në bileta më të lira për udhëtarët tanë.

Ky normalizim do të mundësonte edhe mbikalimin transit nëpër hapësirën tonë të ulët ajrore të shumë avionëve që fluturojnë në aeroportet tjera të rajonit (p.sh. Tirana, Podgorica, Shkupi, Selaniku, Nishi). Nga kjo do të ketë përfitime të ndjeshme financiare për Agjencinë tonë të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, pasi që parashikohet që me normalizimin e hapësirës sonë të ulët ajrore, në këtë pjesë të hapësirës tonë do të mbikalonin rreth 12-15 mijë fluturime në vit (përafërsisht 600,000-750,000 euro të hyra shtesë). Përveç kësaj, rrugët më të shkurtra ajrore do ta bëjnë Aeroportin “Adem Jashari” më konkurrent në rajon dhe më joshës për kompanitë ajrore për shkak të kostos më të ulët të operimit.



Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar disa takime mes Kosovës (ku pjesë e delegacionit ka qenë ASHNA) dhe NATO-s dhe organizatave supranacionale, përkatësisht Stafit Ndërkombëtar të saj në lidhje me çështjen e normalizimit të Hapësirës së Ulët Ajrore.

Edhe Ligji i aplikueshëm në Republikën e Kosovës e njeh mandatin e NATO-s në hapësirën tonë ajrore. Sipas nenit 25.5 të Ligjit 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, “Hyrja në fuqi këtij ligji nuk i heq autoritetin e dhënë Organizatës Veri-Atlantike (NATO) në lidhje me hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës”.

Duke qenë se nuk kishte përparim në bisedime në mes Kosovës dhe Serbisë, NATO vendosi që të ndryshojë objektivin e bisedimeve duke përfshirë edhe Islandën në procesin e normalizimit të hapësirës së Kosovës. ASHNA ka kryer gjithë detyrat e dala si rezultat i këtyre takimeve dhe tani është duke pritur NATO-n që të japë miratimin për nënshkrimin e letër-marrëveshjes me Albcontrol, në mënyrë që të normalizohet rrjedha e trafikut ajror në mes Kosovës dhe Shqipërisë.



KONSUMATORËT DHE PARTNERËT

Bashkëpunimi me konsumatorët

ASHNA përpos ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror për të gjithë konsumatorët, në mënyrë sistematike kujdeset për nivelin e kënaqësisë së tyre.

Për matjen e nivelit të kënaqshmërisë për vitin 2019 me shërbime të ASHNA-së, është aprovuar “Raporti për kënaqësinë e konsumatorit, për vitin 2019”, sipas të cilit vërtetohet për nivelin e kënaqësisë së shfrytëzuesve të shërbimeve të ASHNA-së.

Me qëllim të përmbushjes së nenit 16, pika 1.8, 1.12 dhe 1.13 të Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, ASHNA ka hartuar një pyetësorë me anë të të cilit ka bërë vlerësimin e kënaqësisë së klientëve me shërbimet e ofruara nga ASHNA-ja për vitin 2019.

ASHNA ka mbajtur takim konsultativ me Komitetin e Operatorëve të Linjave Ajrore, me datë 05 dhjetor 2019, me ç'rast është diskutuar për nivelin e kënaqësisë së operatorëve me shërbimet e ofruara nga ana e ASHNA-së për vitin 2019 si dhe planet për vitin 2020.

Në bazë të rezultateve të dala nga ana e hulumtimit, si dhe gjatë komunikimit direkt me përfaqësuesit e kompanive airlines, është vërejtur një nivel i mirë i kënaqësisë me shërbimet e ofruara nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. I gjithë ky rezultat është arritur falë përgatitjes dhe angazhimit të të gjithë stafit të ASHNA-së, me të vetmin qëllim që, operimi në Hapësirën Ajrore të Republikës së Kosovës të jetë në nivelin më të lartë të sigurisë dhe shërbimeve cilësore. ASHNA është e përkushtuar në realizimin e misionit dhe vizionit të tij.



Konsumatorët kryesor

EUROWING

Eurowings

ADRIA AIRWAYS

ADRIA
ADRIA AIRWAYS

ORANGE 2FLY



EDELWEISS AIR

edelweiss

EASYJET

easyJet

WIZZ AIR

W!ZZ

PEGASUS AIRLINE

PEGASUS
AIRLINES

AUSTRIAN AIRLINES

Austrian

TURKISH AIRLINES

TURKISH
AIRLINES

GERMANIA AIRLINES

Germania

ALK JSC

TUI FLY

TUI fly

SWISS INTER AIR LINES

SWISS

NORWEGIAN AIR

norwegian

MABETEX

AEROCLUB SKOPJE

CHAIR

chair

ONUR AIR

Onurair

SUNEXPRESS

SunExpress

Partnerët kryesor

KFOR J3Air



Limak Kosovo International Airport
“Adem Jashari”



Partnerët ndërkombëtarë

Canso



Albcontrol



HungaroControl



MNAV



Bulatsa



Cospas Sarsat



ASHNA DHE ALBCONTROL – MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror e Kosovës – ASHNA dhe Ofruesi i Shërbimeve të Trafikut Ajror të Shqipërisë ALBCONTROL, me datë 09 Korrik, 2019 kanë nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi për Krijimin dhe Zhvillimin e Bashkëpunimit Strategjik.

Menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), i prirë nga Drejtori Bahri Nuredini, ka pritur në takim një delegacion të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Shqipërisë “ALBCONTROL”, në krye me Drejtorin e Përgjithshëm Mina Kusta si dhe Drejtorin e Divizionit për Siguri, Cilësi dhe Sigurim Sokol Ruçi, me ç’rast edhe nënshkruan “Memorandum Mirëkuptimi për Krijimin dhe Zhvillimin e Bashkëpunimit Strategjik”, ndërmjet ASHNA-së dhe ALBCONTROL.

Drejtori Bahri Nuredini, njoftoi kreun e ALBCONTROL, me planet dhe projektet që janë duke u realizuar dhe që pritet të realizohen në të ardhmen në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

“Përmes këtij memorandumi arrihet mirëkuptimi i të dyja autoriteteve që të ndihmojnë njëra-tjetrën në zbatimin e kërkesave ndërkombëtare të rëndësishme për fushën e Shërbimeve të Navigacionit Ajror”.

Nga ana tjetër Drejtori i Përgjithshëm i ALBCONTROL Mina Kusta, shprehu gatishmërinë e tij që të ofrojë ndihmën e ALBCONTROL dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit në mes të ASHNA-së dhe ALBCONTROL.

Qëllimi i këtij Memorandumi është që palët të ndihmojnë njëra-tjetrën, në zbatimin e kërkesave ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil – ONAC, Bashkimit Evropian – BE, EUROCONTROL dhe kërkesave tjera, ashtu si konsiderohen të rëndësishme për fushën e Shërbimeve të Navigacionit Ajror / Menaxhimit të Trafikut Ajror.

Në fund u realizua edhe një vizitë në ambientet e ASHNA-së, me ç’rast Drejtori Bahri Nuredini falënderoi delegacionin e ALBCONTROL për bashkëpunimin dhe ndihmën e ofruar deri më tani.



¹ Fotografi nga dita e nënshkrimit të memorandumit mes ASHNA-së dhe Albcontrol

² Fotografi nga dita e nënshkrimit të memorandumit mes ASHNA-së dhe Albcontrol


Vizitat zyrtare

Përgjatë vitit 2019 është për tu veçuar vizita zyrtare në Izrael ku me ftesë të IMS – Israeli Meteorological Service, nga 02 – 04 Dhjetor 2019, Drejtori i ASHNA-së – Bahri Nuredini, Zëvendës Drejtori për Shërbime Operative – Valmir Hylenaj dhe Menaxheri i Departamentit Meteorologjik – Sherif Gosalci, kanë qëndruar në vizitë pune në Izrael.

Ata janë pritur në IMS nga: z.Nir Stav – Drejtor i Përgjithshëm i IMS, znj.Lilach Lev – Drejtore për Trajnime dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Evgeny Brainin – Përgjegjës për Meteorology Aeronautike si dhe z. Giora Gershtein – Përgjegjës për Klimatologji.



Pas prezentimit të Agjencive të lartëpërmendura diskutimet kanë vazhduar në lidhje me mundësitë e përkrahjes përmes trajnimeve për personelin meteorologjik aeronautikë të ASHNA-së. Menaxhmenti i ASHNA-së ka shprehur konsideratën dhe falënderimin për ofrimin e gjertanishëm të mundësisë së trajnimit për personelin meteorologjik në Qendrën Regjionale të trajnimeve Meteorologjike në Bet Dagan.




Bashkarisht palët u pajtuan me vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen duke pranuar edhe zotimin e palës Izraelite për ofrimin e trajnimeve të ndryshme, konkretisht trajnimin rifreskues për personelin e Departamentit Meteorologjik të ASHNA në vitin 2020, duke i ofruar ato si mundësi edhe në Kosovë.


Delegacioni i ASHNA-së poashtu është pritur në vizitë zyrtare edhe në

Autoritetet Aeroportuale të Izraelit gjegjësisht në kullën e trafikut ajrorë duke u njohur me të arriturat dhe sfidat me të cilat ata ballafaqohen, duke krahasuar edhe ngjashmëritë e situatave dhe pengesat rajonale që ekzistojnë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE



PUBLIKIMI I INFORMATAVE AERONAUTIKE – RKS



Në bazë të planit vjetor të publikimeve për vitin 2019 si dhe kalendarit AIRAC, gjatë Vitit 2019 AIP ka pasur keto publikime:

- AIP AMDT 01/2019 - 20 Qershor 2019:
 - GEN 1.6 – është përditësuar lista e rregolloreve të aplikueshme;
- AIP AIRAC AMDT 01/2019 - 31 Janar 2019:
 - Azhurnimi i hartave te meposhtme:
 - AERODROME, HELIPORT CHART-ICAO BKPR AD 2.24.1.1-1
 - AERODROME PARKING/DOCKING AD 2.24.2.1-1
 - AERODROME GROUND MOVEMENT CHART-ICAO BKPR AD 2.24.3.1-1
- AIP AIRAC AMDT 02/2019 - 28 Mars 2019:
 - Ndryshime në pjesët e mëposhtme:
 - BKPR AD 2.24.1.1-1
 - BKPR AD 2.24.2.1-1

- BKPR AD 2.24.3.1-1
- GEN 4.2
- AIRAC AMDT 03/2019 - 05 Dhjetor 2019:
 - Ndryshime në pjesët e mëposhtme:
 - GEN 0.6
 - GEN 2.1
 - GEN 3.1
 - GEN 3.5
 - ENR 0.6
 - ENR 4.3
 - ENR 1.14
 - AD 0.6
 - AD 1.5
- AIP SUP 01/2019 – 20 Qershor 2019:
 - Informata në lidhjet me punët ndërtimore në hapësirat manovruese në aeroport.
- AIC 01/2019 - 03 Tetor 2019:
 - Qarkorja me informata në lidhje me planin për pastrimin e borës në aeroport dhe infomata tjera në lidhje me sezonin dimëror.
- AIC 02/2019 - 26 Tetor 2019:
 - Qarkorja në lidhje me abonimin në AIP të Kosovës.

Para secilit publikim, sipas procedures, paraprakisht është dërguar njoftimi për publikimin e rradhës tek personat përgjegjës për përmbajtje të AIP-së.

Në bazë të marrëveshjes për këmbim të informacioneve në baza reciproke janë pranuar publikime nga këto shtete: Zvicrra, Norvegjia, Bullgaria, Portugalia, Italia, Maqedonia e Veriut, Rrepublika Çeke, Hungaria dhe Estonia.

Po ashtu është pregatitur plani i publikimeve në AIP për vitin 2020.

MONITORIMI PERFORMANCËS

Monitorimi Performancës

Raporti për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019

FUSHA E PERFORMANCËS SË SIGURISË						
Safety KPI #1: Niveli i Efikasitetit të Menaxhimit të Sigurisë						
		2018 Caku	2018 Vlera aktuale	2019 Caku	2019 Vlera aktuale	2020 Caku
Objektivat fillestare të performancës	ASHNA (Objektivat e menaxhmentit për kulturën e sigurisë	B	B (37.5)	B	C (50)	C
	ASHNA (për të gjitha objektivat tjera të menaxhmentit)	C	C (48.1)	C	C (55.2)	D
	Përputhja me caqet në nivel të BE-së	Sipas AAC: ASHNA pritet që deri në vitin 2020, të arrijë caqet e përcaktuara në nivel të BE-së, ndërsa ka arritur caqet e vendosura në nivel shteti për vitet 2018 dhe 2019. ASHNA ka treguar përparim të dukshëm, sidomos në objektivat që ndërlidhen me Kulturën e Sigurisë. Përparim ka treguar edhe në objektivat tjera të menaxhmentit duke e ngritur nivelin e efikasitetit nga 48.1 në 55.2.				

IKP #2: Aplikimi i klasifikimit të rrezikshmërisë përmes metodologjisë së veglës për analizë të rrezikut (RAT)						
OSHNA		2018 Caku	2018 Vlera aktuale	2019 Caku	2019 Vlera aktuale	2020 Caku
Caqet në nivel të BE	SMI ³	>= 80%	-	>= 80%	100%	100%
	RI ⁴	>= 80%	-	>= 80%	100%	100%
	ATM-S ⁵	>= 80%	-	>= 80%	100%	100%
Caqet në nivel të BE	SMIs	90%	N/A	95%	N/A	100%
	RIs	90%	N/A	95%	100%	100%
	ATM-S	90%	N/A	95%	95%	100%
Përputhja me caqet në nivel të BE-së		Në nivel të ASHNAs, caqet dhe performanca e matur janë në përputhje me caqet e caktuara në nivel të BE-së.				
Arsyetimi në rast të devijimit		ASHNA nuk ka pasur qasje në veglën RAT të Eurocontrol, prandaj nuk ka mundur të aplikojë atë gjatë vlerësimit të ndodhive. Qasja është rifituar vetëm në vitin 2018. Nuk është ofruar trajnimi i personelit për përdorim të veglës e-TOKAI pjesë e së cilës është edhe RAT analiza. Pritet që në të ardhmen të realizohet objektivi prej 100%.				

³ Humbjet e seperimit (Separation Minima Infringement - SMI)

⁴ Ndërhurjet në pistë (Runway incursion – RI)

⁵ Ndodhitë që kanë të bëjnë me Menaxhimit e Trafikut Ajror (Air Traffic Management related occurrences)

Kapaciteti						
KPI #2: ASHNA ATFM VONESAT AEROPORTUALE DHE TERMINALE NË ARDHJE PËR FLUTURIM						
		2018 Caku	2018 Vlera aktuale	2019 Caku	2019 Vlera aktuale	2020 Caku
Niveli kombëtarë	Objektivi fillestar i performancës	3 (min/fluturim)	3.46 (min/fluturim)	3 (min/fluturim)	≤3 (min/fluturim)	3 (min/fluturim)
	Numri i aeroportëve Brenda fushëveoritë planit të performancës	1				
ASHNA	ASHNA - BKPR (Prishtina International Airport)	3.5 (min/fluturim)	N/A	3 (min/fluturim)	N/A	3 (min/fluturim)
	Kontributi i aeroportëve në planin e performancës	Pasi që ka vetëm një aeroport në Kosovë, kontributi i aeroportit në lidhje me vonesat në nivel kombëtarë është 100%				

Komente shtesë

Për momentin Kosova nuk është pjesë e Menaxhimit të Rrjetit (Network Manager), dhe si rrjedhojë nuk bën pjesë në rregulloren e ATFM për alokim të vendit/sllotit. Për këtë arsye, NSA e Kosovës për momentin nuk pranon të dhëna nga Menaxheri i Rrjetit. Vonesat e fluturimeve për fluturake në aeroport dhe terminal të ANS ATFM definojnë si në vijim:

“Mesatarja e kohës së vonesës së arritjes që i atribuohen shërbimeve për navigim ajror dhe shërbimeve terminale dhe që shkaktohen nga restriksionet gjatë aterimit në aeroportin e destinimit, definojnë si në vijim:

- (i) treguesi është mesatarja e gjeneruar e vonesës nga ATFM vonesa për çdo flutrim IFR;
- (ii) treguesi i mbulon të gjitha fluturimet IFR që aterojnë në aeroportin e destinacionit dhe të gjitha shkaqet e vonesës ATFM, me përjashtim të ngjarjeve të jashtëzakonshme;
- (iii) treguesi llogaritet për tërë vitin kalendarik dhe për çdo vit të periudhës referuese.”

Për më shumë, treguesi kalkulohet për rrjedhën e fluturimeve hyrëse që arrijnë në aeroport, përfshin një pjesë të vonesës para nisjes e cila shkaktohet nga kufizimet e aterimit në aeroportin e destinimit. Duke patur parasysh definimin e shkruar më lartë, pa të dhëna nga Menaxheri i Rrjetit, është e pamundur të llogaritet historiku i saktë i kësaj mesatareje të KPI.

Deri më tani, NSA e Kosovës në bashkëpunim me ANSPA të Kosovës ka shikuar të dhënat e të kaluarës që ruhen lokalisht, të cilat bazohen në alokim vendi/sllot në aeroport procedurë lokale, koha e përafërt e arritjes (ETA) (për të gjitha fluturimet hyrëse) dhe koha e saktë e arritjes. *Keni parasysh, alokimi i vendit në aeroport procedurë lokale nuk kryhet në kordinim me menaxherin e Rrjetit.* Si rrjedhojë, dy lloje vonesash të përsëritura janë kalkuluar për fluturimet ateruese:

- 1) në lidhje me alokimin e vendit në aeroport, si diferenca (në minuta) në mes të ATA dhe slotit, dhe
 - 2) referuar ETA, si ndryshim (në minuta) mes kohës ATA dhe ETA.
- Sidoçftë, shkak që sllotet nuk janë të kordinuara, lloji i parë i vonesës rezulton në vlera të mëdha vonesa për fluturim. Kjo për shkak që, një vonesë e tillë mbulon vonesën e përgjithshme të fluturimit që mund të përfshijë: vonesa të shkaktuara në aeroportin e nisjes, vonesat gjatë rrugës si dhe vonesat në aeroport dhe fazën e fundit.

Lloji i dytë i vonesës rezulton me vlera shumë më të vogla, pasi që i mbulon vetëm vonesat e shkaktuara mes kohës kur fluturimi kordinohet/transferohet mes njesive të ATC'së.

Në mënyrë që të kemi një vlerë njëjës të vonesës, ne kemi zgjedhur të përdorim një mesatare të kapshme të dy llojeve të vonesës. Shkak që, siç e përmendëm sllotet nuk kordinohen, është mendim i yni që lloji i dytë i vonesës është më i përafërt me vonesën reale të ATFM's. Si rrjedhojë ne i kemi caktuar një vlerë prej 20% vonesës së parë dhe 80% vonesës së dytë. Vlera mesatare e vonesës së 2 viteve të mëparshme është caktuar si synim për vitin në vijim, pasi që nuk priten zhvillime të mëdha.

Keni parasysh, pasi që BKPR për momentin nuk ka limite në kapacitet, ne nuk presim që vonesa mesatare të shënojë rritje me rritjen e numrit të trafikut. Duke shikuar të dhënat e të kaluarës, vonesat mesatare shkaktohen ose janë gjatë sezonit të dimrit, ne mund të vijmë në përfundim që shumica e vonesave lokale janë si shkak i motit të ligë, në veçanti mjegullës së dendur në afërsi dhe rreth aeroportit.

Pasi që egzistojnë planët për instalim të paisjes së re ILS (CAT IIIB), sistemit AWOS dhe ri-hapja e korridoreve të reja ajrore, ne presim që vonesat mesatare do të zvogëlohen në vitet 2019-2020.

Vëmendje: Kjo pjesë e planit mund të ndryshojë në vitet në vijim, nëse Kosova merr të dhënat direkt nga Menaxheri i Rrjetit.

Cost efficiency	
KPI #2: Unit cost for terminal ANS	
[Kosovo Terminal]	
	2019
Total terminal actual/forecast costs in nominal terms (in national currency)	4,755,498
Inflation %	2.10%
Inflation index (Base = 100 in 2012)	106.27
Total terminal actual/forecast costs in real terms (in national currency at 2012 prices)	4,457,376
Total terminal Service Units (TSU)	11,272
Real terminal UCs (in national currency at 2012 prices)	395.44

Values at 2012 prices	2019
2012 average exchange rate (1EUR=)	1
Total terminal costs in real terms (in €2012 prices)	4,457,376
Trend in total terminal costs in real terms %n/n-1	15.5%
Real terminal UCs (in €2012 prices)	395.44
Trend in real terminal UCs (in €2012 prices) %n/n-1	2.8%
Values at 2009 prices	2019
Inflation index (Base = 100 in 2009)	119.56
2009 average exchange rate (1EUR=)	1
Total terminal costs in real terms (in €2009 prices)	3,825,179
Trend in total terminal costs in real terms %n/n-1	15.8%
Real terminal UCs (in €2009 prices)	339.35
Trend in real terminal UCs (in €2009 prices) %n/n-1	2.43

Justification	
Description and justification of how the local initial performance targets contribute to the performance of the European ATM network	

Inflation Assumptions	
[Kosovo Terminal]	2019
Inflation %	2.10%
Inflation index (2012=100)	106.27
Eurostat HICP (actuals) and IMF CPI (forecasts)	
Inflation index (2012=100) HICP and IMF	
Difference in percentage points	
Cumulative difference in percentage points	
Justification and data source in case of deviation from	

Service Units forecast for terminal				
	[Kosovo Terminal]	2018 A	2019 A	2020 P
	Total terminal service units (TSU)	10,427	11,272	11,835
	Year on Year variation TSU		8.16%	5.00%
baseline	STATFOR terminal service units forecast (Baseline			
	Year on Year variation TSU STATFOR			
	Difference in percentage points			
	Cumulative difference in percentage			
low	STATFOR terminal service units			
	Year on Year variation TSU STATFOR			
	Difference in percentage points			
	Cumulative difference in percentage points			
	Explanation of the differences (if any), justification, rationale			

Shërbimet terminale

Operimet komerciale			Krahasimi me vitin paraprak	
Muaji	2018	2019	Nr. i operimeve	%
Janar	1166	1366	200	17.2%
Shkurt	943	1086	143	15.2%
Mars	1151	1257	106	9.2%
Prill	1322	1420	98	7.4%
Maj	1407	1556	149	10.6%
Qershor	1432	1599	167	11.7%
Korrik	1878	2170	292	15.5%
Gusht	2015	2309	294	14.6%
Shtator	1446	1549	103	7.1%
Tetor	1402	1321	-81	-5.8%
Nentor	1201	1198	-3	-0.2%
Dhjetor	1387	1367	-20	-1.4%
TOTAL	16750	18198	1448	8.6%

Njësitë e shërbimit

Në vitin 2018, ASHNA ka pasur një ngritje të njësive terminale të shërbimit krahasuar me vitin 2017 në lartësi prej 8.16%

Gjatë vitit 2018 janë ofruar 10,427 njësi shërbimi ndërsa në vitin 2019 janë ofruar gjithsej 11,272 njësi.

Tarifimi

Llogaritja e tarifës njësi për tarifën terminale të navigacionit (TNC) për vitin 2019 ka rezultuar nga zbatimi i metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren nr. 3/2016 të AAC-së mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror. Bazuar në këtë metodologji, TNC llogaritet për vitin "n" në bazë të kostove dhe trafikut të vlerësuar për atë vit.

2019 është viti i tretë i aplikimit të kësaj metodologjie, ndërsa që nga ndarja e saj nga operatori i aeroportit në vitin 2011, ASHNA ka vjelur një tarifë prej 5.20 eurove/ton (baza: Pesha maksimale e ngritjes së avionit - MTOW).

Tarifa njësi

Krahasuar me vitin paraprak, tarifa njësi nuk ka pasur ndryshim: 2018 – 378 € / 2019 – 378 €.

Treguesit e performancës



SIGURIA

ASHNA gjatë vitit 2019 ka dëshmuar përkushtimin dhe profesionalizmin në zbatimin e kërkesave të sistemit për menaxhimin e sigurisë. Për më tepër ka qenë e përkushtuar në përmirësimin e performansës së sigurisë për të përmbushur kërkesat ligjore si dhe rekomandimet që rezultojnë nga aktivitetet e ndryshme të sigurisë.


Në ASHNA-së, gjatë vitit 2019 janë regjistruar:

Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës në aspektin e Sigurisë së


ASHNA-s janë paraqitur në formë të Aneksit 1 të këtij Raporti. Në këtë Aneks është paraqitur performansa e Sigurisë kundrejt caceve të sigurisë.

Në përgjithësi në departamentin e DCSS janë regjistruar:

- Ndodhi të kategorisë A (aksidente) – 0
- Ndodhi të kategorisë B (incidente) – 6
- Ndodhi të kategorisë B (zvogëlim i ndarjes) – 0
- Ndodhi të kategorisë C – 67 (67 ndodhi në 96 raporte)
- Ndodhi të kategorisë D – 73 (73 ndodhi në 75 raporte)



Krahasueshmëria 2016 - 2017 - 2018 - 2019



Caqet dhe treguesit kyç të performansës së Sigurisë për vitin 2019

Nr	TKP (SPI) për procese	Totali i ndodhive në vitin 2019	Totali i ndodhive në vitin 2018	Treguesi i sigurisë	Masat e parapara	Caqet e performansës së sigurisë për vitin 2019
1	Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM)	7	7	Numri i incidenteve me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM)	Të vetëdijesohet stafi që në mënyrë proaktive të identifikojë hazardet që mund të shpijnë drejt cenimit të sigurisë.	Numri i incidenteve me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 incidente në vit
2	Funksionet e Komunikimit	11	9	Numri i dështimeve të funksionit të Komunikimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Janë planifikuar prokurimi i sistemit të ri të radiove nga ASHNA, si dhe radio të reja janë përfshi në projektin për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për “Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterrimin dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari” nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017)	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Komunikimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 15 dështime në vitin 2019

3	Funksionet e Navigimit	2	2	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Janë planifikuar sistemet e reja të navigimit në projektin për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për “Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterrimit dhe sistemeve të radiokominikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari” nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017)	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Navigimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 5 dështime në vitin 2019.
4	Funksionet e Survejimit	18	5	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Është planifikuar prokurimi i sistemit të ri të survejimi si dhe jemi në proces të rregullimit dhe azhurimit të sistemit ekzistues PSR/MSSR.	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Survejimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 5 dështime apo 94 orë në vitin 2019, përfshi këtu edhe ndërprerjet për mirëmbajtje të planifikuar

5	Funksioni ndihmës i informimit	23	35	Numri i dështimeve të funksionit Ndhmës të informimit duhet të zvogëlohet	Janë planifikuar sistemet e reja dhe azhurimi i atyre ekzistuese në projektin për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për “Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterrimit dhe sistemeve të radiokominikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari” nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017)	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të funksionit ndihmes te informimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 25 dështime në vitin 2019
6	Funksionet e procesimit të të dhënave	9	5	Numri i dështimeve të funksionit procesimit te te dhenave duhet të zvogëlohet	Është planifikuar duplikimi i sistemit AFTN si projekt kapital për vitin 2019. Ne kete projekt jane te perefshira edhe trajnimet nga prodhuesi për intervenime të nivelit të dytë	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Procesimit të të dhënave me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 7 dështime në vitin 2019
7	Të tjera	4	2	Numri i dështimeve tjera duhet të zvogëlohet	Janë planifikuar trajnime të ndryshme profesionale dhe nga aspekti i sigurisë me të cilat parashihet mes tjerash edhe ndërgjegjësim i personelit në raport me përgjegjësitë e tyre që ndërlidhen me siguri.	Numri i ndodhive të dështimit të funksioneve tjera me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 në vitin 2019.
Totali		74	65			

Arsyeshmëria për rritjen e ndodhive të raportuara

Nga tabela e cageve dhe treguesve kyç të performancës së sigurisë për vitin 2019 (aneksi 01 i këtijë raporti), vërehet se një rritje e lehtë në raportimet e ndodhive.

Në fushën e funksionit të komunikimit, vërehet se ka rritje nga viti paraprak mirëpo brenda caktit të performancës së përcaktuar.

Në fushën e funksionit të survejimit ka pasur rritje nga caku i performancës së përcaktuar, mirëpo duhet theksuar se këtu janë përfshirë të gjitha dështimet në funksionin e survejimit të cilat janë shkaktuar edhe nga faktor tjerë si ndalja e rrymës, pezullimi i shërbimeve radarike për shkak të problemeve me DLT (recorder) si dhe dështimi i kabllit optik në linjën Golesh-ASHNA.

Në fushën e funksionit të procesimit të të dhënave, ka pasur rritje nga viti paraprak si dhe kanë qenë dy ndodhi më shumë se caku i performancës për këtë fushë. Nodhitë kryesisht kanë të bëjnë me problemet e shkaktuara në AFTN, ku për shkaqe të ndryshme ka dështuar sistemi AFTN si dhe janë bërë ndërprerje të kontrolluara gjatë projektit “Duplikim i sistemit AFTN”. DTEK ka marr të gjitha masat në mënyrë që të mbahen sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme dështimet në këtë fushë.

Duhet theksuar se këto ndodhi janë edhe si pasojë e vjetërsisë së pajisjeve, të cilat janë planifikuar të modernizohen me sistemet e reja dhe azhurimin e atyre ekzistuese në projektin për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për “Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterritimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari” nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017).

Incidentet kanë qenë 7 në vitin paraprak, prap kanë mbetur në 7, që është më e ulët se caku i performancës ku janë paraparë jo më shumë se 10 incidente në vit. Numri i këtyre ndodhive nuk ka të bëjë me performancën e pajisjeve apo personelit në ASHNA, por janë si rrjedhojë e veprimeve të palëve të jashtme (kryesisht pilotët).

Vlen të theksohet se edhe ngritja e nivelit të vetëdijësimit të personelit për raportime, duke pasur parasysh angazhimin e menaxhmentit në fuqizimin e “No Blame Policy”, ka ndikuar në rritjen e raportimeve, gjithmonë në funksion të identifikimit dhe përmirësimit të zbratësirave të mundshme, si dhe ngritjes së kapaciteteve, me qëllim të ngritjes së nivelit të përgjithshëm të sigurisë.

OPERIMET

Mbarëvajtja e operimeve gjatë vitit 2019, është menaxhuar nga ASHNA sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Manualët e Operimeve të njësive përgjegjëse. Nuk është paraqitë ndonjë problem profesional me ndikim të drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve.


Të gjitha operimet janë menaxhuar sipas rregullave dhe procedurave dhe sipas kritereve të caktuara për siguri, efikasitet dhe rrjedhshmëri të rregullt të trafikut.

Operimet komerciale për vitin 2019 kanë shënuar rritje prej 8.64%, ndërsa operimet ushtarake dhe VFR kanë pësuar një rënie prej 2.48% përkatësisht 25.93%. Në përgjithësi, ASHNA gjatë vitit 2019 i ka ofruar shërbime të navigacionit ajror 21,630 fluturakeve, që në krahasim me vitin 2018 që kanë qenë 21,026 operime, paraqet një rritje prej 2.87%.




Operimet komerciale

Operimet komerciale			Krahasimi me vitin paraprak	
Muaji	2018	2019	Nr. i operimeve	%
Janar	1166	1366	200	17.2%
Shkurt	943	1086	143	15.2%
Mars	1151	1257	106	9.2%
Prill	1322	1420	98	7.4%
Maj	1407	1556	149	10.6%
Qershor	1432	1599	167	11.7%
Korrik	1878	2170	292	15.5%
Gusht	2015	2309	294	14.6%
Shtator	1446	1549	103	7.1%
Tetor	1402	1321	-81	-5.8%
Nëntor	1201	1198	-3	-0.2%
Dhjetor	1387	1367	-20	-1.4%
TOTAL	16750	18198	1448	8.6%




Operimet Ushtarake

Operimet Ushtarake			Krahasimi me vitin paraprak	
Muaji	2018	2019	Nr. i operimeve	%
Janar	82	88	6	7.3%
Shkurt	78	95	17	21.8%
Mars	108	97	-11	-10.2%
Prill	105	98	-7	-6.7%
Maj	106	92	-14	-13.2%
Qershor	92	72	-20	-21.7%
Korrik	80	80	0	0.0%
Gusht	96	88	-8	-8.3%
Shtator	86	78	-8	-9.3%
Tetor	120	90	-30	-25.0%
Nëntor	88	91	3	3.4%
Dhjetor	88	132	44	50.0%
TOTAL	1129	1101	-28	-2.5%




Operimet VFR

Operimet VFR			Krahasimi me vitin paraprak	
Muaji	2018	2019	Nr I operimeve	Perqindja
Janar	244	86	-158	-64.8%
Shkurt	256	196	-60	-23.4%
Mars	302	250	-52	-17.2%
Prill	246	223	-23	-9.3%
Maj	338	181	-157	-46.4%
Qershor	204	264	60	29.4%
Korrik	295	214	-81	-27.5%
Gusht	280	200	-80	-28.6%
Shtator	287	248	-39	-13.6%
Tetor	268	192	-76	-28.4%
Nëntor	259	163	-96	-37.1%
Dhjetor	168	114	-54	-32.1%
TOTAL	3147	2331	-816	-25.9%



Operimet e gjithmbarshme

	Operimet e Gjithmbarshme		Dallimi
	2018	2019	Perqindja
Komerciale	16750	18198	8.64%
Ushtarake	1129	1101	-2.48%
VFR	3147	2331	-25.93%
	21026	21630	2.87%



Regjistri i top kompanive ajrore, të cilave ASHNA ju ka ofruar shërbime

	2019	Nr i operimeve
1	EUROWINGS	1391
2	ADRIA AIRWAYS	1222
3	ORANGE2FLY	1128
4	EDELWEISS	848
5	EASYJET	844
6	WIZZAIR	782
7	PEGASUS AIRLINES	756
8	AUSTRIAN AIRLINES	735
9	TURKISH AIRLINES	728
10	GERMANIA FLUG	505
11	ALK JSC	463
12	TUI FLY	309
13	SWISS INT AIRLINES	186
14	NORWEGIAN AIR	184
15	MABETEX	156
16	AEROCUB SKOPJE	145
17	CHAIR	119
18	GERMANIA	87
19	ONUR AIR	65
20	SUNEXPRESS	64

KOMUNIKIMI, NAVIGACIONI DHE VËZHGIMI

Projekti i zgjatjes së pistës

Gjatë vitit 2019 ka vazhduar implementimi i këtij projekti kapital. Vlen të potencohet edhe njëherë që me këtë projekt janë të parapara edhe një numër i projekteve me rendësi të veçant për ASHNA-n (Sistemi i Radiokomunikimeve, AWOS, ILS,...). Prej ASHNA-së është krijuar një ekip gjegjësisht koordinatori dhe nënkoordinatorët që do të jenë në mbikqyrje të projekteve që janë destinuar për ASHNA-n deri në pranimin e tyre. Stafi i DTEK dhe departamenteve përkatëse është marrë me evaluimin e shumicës prej ofertave të pranura përgjatë vitit 2019 dhe ka dhënë përgjigjet e tyre.

Siç dihet, me këtë projekt pritet që të realizohen një numër i madh i projekteve kapitale të ASHNA-s. Sipas kontratës ASHNA ka një rol aktiv në këtë projekt.

Sistemet të cilat do të instalohen me këtë kontratë janë:

- Sistemi i Radiokomunikimit;
- Sistemi i Vëzhgimit të motit (AWOS-Automatic Weather Observation System) CAT 3b;
- Azhurnimi i Sistemit ekzistues AWOS;
- Sistemi VOLMET;
- Sistemi për parashikimin e motit (Forecast);
- Sistemi i aterimit instrumental (ILS-Instrumental Landing System);
- PBN procedurat;
- Rilokimi i DVOR-it ekzistues;
- Procedurat për vajtje ardhje (STAR dhe SID);
- Procedurat instrumentale konvencionale;
- Sistemi i furnizimit me energji elektrike;
- Vlerësimi i pengesave;
- Rrjeti i komunikimit dhe energjisë elektrike në hapsiren manovruese;
- Linja optike Golesh-ASHNA.


Sistemi i Radiokomunikimit

LIMAK ka nënshkruar kontratën me kompaninë JOTRON –TELELINK për implementimin e projektit të radiokomunikimit në Golesh & ASHNA me VCS-në, si dhe integrimin në VCS-në dhe VCR ekzistuese.

Ka pasur një takim njoftues me LIMAK dhe kompaninë implementuese (JOTRON-TELELINK). Në takim, përpos njoftimit me ekipën implementuese nga Jotron dhe përcjellëse nga ASHNA, është bërë edhe vizita në lokacionet ku do të instalohen sistemet. Menaxheri i projektit nga JOTRON është zotuar se shumë shpejt do të dërgoj planin detal të implementimit të këtyre projekteve, përfshirë pranimet teknike FAT (Factory Acceptance Test), trajnimin e stafit teknik dhe operativ, instalimin dhe komisionimin –SAT (Site Acceptance Test), si dhe lëshimin në operim.

JOTRON ka kërkuar konfirmimin e frekuencave të radiove nga specifikimi teknik. Arsyeja për këtë është se sistemi është në prodhim dhe si i tillë duhet dimensionuar me saktësi. Ende nuk është dhënë konfirmimi, meqenëse ka pasur dakordim me J6 dhe me Hungarocontrol.

Pritet që në periudhën vijuese të zgjidhen çështjet me frekuencat duke konsideruar edhe zotimin nga ARKEP se do të dërgoj sugjerimin përfundimtar se cilat frekuenca duhet të përdoren nga sistemet tona.




Sistemi i vëzhgimit të motit (AWOS)

Me zgjatjen e pistes, sipas projektit, do të rritet edhe kategoria e operativitetit të aeroportit nga kategoria aktuale II në kategorinë IIIB. Nga ana e LIMAK jemi njoftuar se ata kanë nënshkruar kontratën me kompaninë DTN për Sistemin vëzhgimit të motit – AWOS IIIB. Së fundmi ka pasur një takim në mes DTN, ASHNA-së dhe LIMAK në lidhje me implementimin e projektit.

Inxhinjerë e DTN na kanë njoftuar se projekti i AWOS IIB do të përfundohet në prill 2020, ndërsa azhurimi i AWOSit ekzistues, ATIS dhe VOLMET në qershor 2020. Afatet për FAT dhe trajnime janë të njëjtat (mars 2020) por që ende nuk janë përfundimtare.

Sipas dinamikës së paraparë pritet që Sistemi i vëzhgimit të motit AWOS IIIB të jetë plotësisht operativ në tremujorin e tretë të vitit 2020.



Azhurimi i Sistemit ekzistues AWOS

Krahas furnizimit me sistemin e ri AWOS IIIB, nga LIMAK jemi njoftuar se nga kompania DTN, do të bëhet edhe azhurnimi i sistemit ekzistues AWOS.

Sipas ofertës sistemi do të jetë komplet i ri dhe në redudancë me sistemin ekzistues. Kjo është konfirmuar edhe në takimin e fundit me përfaqësuesit e kompanisë implementuese. Edhe ky projekt sipas dinamikës së paraparë pritet që Sistemi i vëzhgimit të motit AWOS IIIB të jetë plotësisht operativ në tremujorin e tretë të vitit 2020.



Sistemi VOLMET

Përveq furnizimit me sistemin e ri AWOS IIIB, azhurimi i sistemit ekzistues AWOS, nga LIMAK jemi njoftuar se nga kompania DTN, do të bëhet edhe implementimi i projektit të VOLMET që përfshinë edhe ATIS-in e ri. Sipas inxhinjerëve të DTN, projekti ATIS dhe VOLMET pritet të implementohet në qershor.

Përndryshe, çështja e frekuencave të ATIS dhe VOLMET është sqaruar me ARKEP-in

Është zgjidhje fleksibile dhe gjithëpërfshirëse për shpërndarjen e mesazheve VOLMET tek fluturaket gjatë fluturimit. Sistemi VOLMET - është një produkt i bazuar në PC që vepron në një mjedis të Windows. Sistemi VOLMET është zhvilluar duke përdorur një dizajn fleksibël, modular, dhe është i konfiguruar që lehtë të përmbushë kërkesat specifike të konsumatorit. Ky sistem përdor një proces apo brez tekst-fjalë për të gjeneruar automatikisht një transmetim VOLMET.

I Instaluar në kompjuterë- VOLMET është një paketë e ekzekutueshme softverike me mbështetjen e konfigurimit, dhe një bazë të dhënash e dosjeve të digjitalizuara që përmbajnë një fjalor të gjerë të kushteve të motit dhe të cilat janë të nevojshme dhe të domosdoshme për transmetimet VOLMET.

MetConsole® Automatic Terminal Information Service (ATIS)

18:35:55 | 06:25 | 17:17

Left Sidebar:

- AWOS: Home, PTH, Wind, Clouds, RVR, BITE
- Windshear Warning: LLWAS Main, LLWAS Spec, LLWAS, Radar and Satellite
- Additional Systems: Lighting, Water Film Depth, Surveillance, Online Resources
- ATIS: ATIS, MET ATIS, ADO ATIS
- Aeronautical Messages: Reports Summary, MetReport, METAR, TAF, SKIMET, SYNOP, VOLMET

Top Section:

- New Message:** Pause, Update, Send, Cancel
- Audio Functions:** Preview, Current, Replace, Append
- Runway In Use:** Arrival: 05, Departure: 23
- Last Messages:** Last Sent ATIS: 01 18:33:00, Last MET ATIS: 01 18:33:00, Last ADO ATIS: ?
- Operational Information:** Approach Type: vectoring for ILS approach, Surface Condition: Rwy 05/23, Braking Action: Rwy 05/23, Holding Delay: 2 min, Transition Level: 0, Other Information: ?
- Meteorological Data:** Wind Direction: 200 (Min: 190, Max: 210), Wind Speed: 09 (Min: 05, Max: ?), Visibility: 8000 (Vertical: ?), RVR TDZ: ABV, RVR MD: ABV, RVR END: ?, Present Weather: ?, Clouds: ?, Dew Point: 14.0, Temperature: 21.0, QNH: 1014.0, Windshear: ?, Trend Forecast: ?


Bottom Section:

- Settings:** Operational Mode: Manual, Allow Non-Dictionary Words, Replace ATIS by 'Other Information' Field, Next Message Scheduled: 28 18:28:33, Auto-Send Timer, Quality Check Warnings
- Last ATIS Letter:** B
- Last Sent ATIS:** This is MetConsole Information Charlie. 1833. Expect vectoring for ILS approach. Runway 05 for arrival, runway 23 for departure. Delay 2 minutes. Transition level 45. Wind, 200 degrees, 9 knots. Visibility 8 kilometres. Cloud, unavailable. Temperature 21. Dewpoint 14. QNH 1014. Acknowledge Information Charlie on first contact.

DTN CUSTOMER

Sistemi për parashikimin e motit

Në pjesën e dytë të 2019 neve si ASHNA jemi njoftuar se LIMAK ka arritur marrëveshje me kompaninë franceze të specializuar për sistemet meteorologjike COROBOR për projektin Sistemi për parashikimin e motit. LIMAK është zotuar se shumë shpejt do të dergoj planin detal të implementimit të këtij projekti, përfshirë pranimet teknike FAT (Factory Acceptance Test), trajnimin e stafit teknik dhe operativ, instalimin dhe komisionimin –SAT (Site Acceptance Test), si dhe lëshimin në operim. Edhe ky projekt pritet të përfundojë në pjesën e dytë të vitit 2020. Sistemi për parashikimin e motit, është sistem që përdoret për përgatitjen e parashikimeve meteorologjike aeronautike. Përmes këtij sistemi kontribohet në përgatitjen e produkteve si TAF, SIGMET, AIRMET, Cross Section, 7 Day Forecast, LAF PM & AM dhe produkte të tjera të veqanta të kërkuara nga shfrytëzuesit aeronautik.



Sistemi i aterimit instrumental (ILS)

Një sistem tjetër i rëndësishëm që e mundëson ngritjen e kategorisë së aeroportit në kategorinë IIIB është sistemi instrumental i aterimit. Duhet potencuar se në kuadër të këtij projekti ASHNA do të furnizohet me ILS CAT IIIB për pistën 17 dhe ILS CAT I për pistën 35.

Pas përfundimit të procedurave të FAT-it, kontraktori ka sjell në Kosovë sistemin e prodhuar ILS Cat IIIB. Në të njëjtën kohë janë duke vazhduar edhe punët civile për instalimin e sistemit. Disa prej punëve civile (kablrimi dhe sistemi i furnizimit me energji elektrike) janë pjesë të projekteve respektive.

Për ILS CAT I, furnitori përprodhimin e sistemit dhe përfundimin e FAT përmes LIMAK ka kërkuar që t'ju dërgojm frekuencat që do të përdoren për dy sistemet e ILS 17 dhe ILS 35.

Për ILS CAT III B RWY 17 kemi kërkuar që të perdoret frekuenca e njëjtë që kemi në shfrytëzim, kurse për ILS CAT I RWY 35 do të sigurohet një frekuencë e re. Frekuenca do të sigurohet sipas të njëjtës procedurë sikurse ajo e VOLMET-it (KFOR).

Në ndërkohë frekuenca për shfrytëzim e sistemit ILS Cat I na është konfirmuar nga autoritetet relevante. Të njëjtën e kemi dërguar tek LIMAK dhe (përmes LIMAK) tek prodhuesi.

Me të marrë frekuencen, kontraktori ka caktuar datën për të kryer procedurat e FAT-it për këtë sistem. Këto procedura do të kryhen në fillim të vitit 2020.



PBN procedurat

Implementimi i këtij projekti ka filluar dhe pritet të përmbyllet në pjesën e dytë të vitit 2020. Ka pasur një vizitë nga kompania e kontraktuar nga LIMAK e që është kompania franceze – CGX.

Udhëzuesi për shtetet që të realizojn implementimin e rrugëve ajrore dhe te procedurave për vajtje ardhje është i përshkruar në Manualin për Navigim i Bazuar në Performance (PBN) Dokumenti 9613.2.

Implementimi i këtyre rrugëve në koncept bazohet në sinjale satelitore të cilat i mundësojnë pilotit navigim me efikas, rrugë më të shkurtër për dhe nga aeroportet, menaxhim me i lehtë i rrjedhjes së trafikut ajror dhe ndarjes së aeroplanëve në ajër, eliminon nevojën për pajisje navigimi në toke, zvogëlon ndikimin në mjedis zvogëlon nevojën për pajisje.

Rilokimi i DVOR-it ekzistues

Rilokimi i sistemit të DVOR-it është realizuar në Qershor të vitit 2019, por ky sistem do të hyjë në operim vetëm pasi të bëhët edhe testimi dhe kalibrimi nga ajri ("Flight Check"), të cilën LIMAK do të performoj në fazat tjera të projektit. Poashtu, LIMAK sipas kontratës ka detyrim të bëjë edhe trajnimin e stafit teknik për këtë sistem, të cilën do të bëjë në fazat tjera të realizimit të projektit përgjatë vitit 2020.



Procedurat STAR dhe SID (vajtje ardhje)

Implementimi edhe i këtij projekti ka filluar dhe pritet të përmbyllet në pjesën e dytë të vitit 2020. Ka pasur një vizitë nga kompania e kontraktuar nga LIMAK e që është poashtu kompania franceze –CGX.

Procedurat e vajtje ardhjeve (STAR dhe SID) janë procedura të dizajnuara që përcaktojnë rrugën e paracaktuar të ardhjes dhe shkuarjes së aeroplanëve në hapsirën ajrore të Kosovës. Meqenëse procedurat janë të lidhura me aspektet fizike të infrastrukturës së aeroportit, ASHNA me kohë dhe sipas përgjegjësive që ka në projektin zgjatja e pistës ka përfunduar vlerësimin e ofertave të ofruara nga LIMAK dhe pritet në vijim të vitit 2019 fillimi i implementimit të projekti.

Sistemi i furnizimit me energji elektrike

Me projektin e zgjatjes së pistes në hapsiren manovruese është parapare edhe kyqja e sistemeve të instaluara në hapsiren manovruese në një sistem qendror të furnizimit me energji elektrike.

Në lidhje me këtë projekt, kemi qenë të kontaktuar nga inxhinjeri i pavarur, me ç'rast jemi njohtuar se LIMAK iu ka kërkuar pëlqimin e dizajnit të objektit për sistemimin e sistemit të furnizimit me energji elektrike. Në teren vërehetse punimet tanimë kanë filluar.

Ky sistem është paraparë që të jetë në përputhje me rekomandimet e ICAO-s për furnizimin me energji elektrike që nënkupton burimin kryesor dhe dytësor të energjisë elektrike si dhe sistemet që mundësojnë mos ndërprerjen e furnizimit gjatë periudhes kalimtare. E njëjta infrastrukturë komunikuese do të shtrihet edhe në drejtim të lokacionit të Goleshit, ku gjinden disa sisteme shumë të rëndësishme të ASHNA-s siq janë RADAR-i MSSR Mode S, Sistemi i radiove etj.



Vlerësimi i pengesave (Obstacle survey)

Sipas raportimit të nën koordinatorit të këtij projekti, implementimi i kësaj pjese të punës ka filluar përgjatë vitit 2019 dhe pritet të përfundojë në 2020.

Projekti “Duplifikimi i Sistemit AFTN”

Nga departamenti DCSS me datë 09.01.2019 është marrë vlerësimi i riskut të bërë për projektin “Duplifikim i sistemit të AFTN-së”. Pas vlerësimit të riskut të inicuar nga DCSS, ka pasuar revidimi i specifikacionit teknik konform detyrimeve të dala nga ky dokument i vlerësimit të riskut. Pas revidimit të specifikacionit teknik konform këtij dokumenti, i njëjti është ridërguar në zyrën e prokurimit për procedura të metujeshme si projekti “Duplifikimi i Sistemit AFTN”. Projekti është prokuruar dhe pas përfundimit të procedurave, është bërë nënshkrimi i kontratës.

Kontrata është implementuar në fund të nëntorit 2019, sipas termeve të specifikacioneve teknike. Poashtu, në fund të implementimit është kryer edhe trajnimi i stafit të mirëmbajtjes.

Projekti “Furnizim me sistemet e Navigimit dhe rilokimi i sistemeve ekzistuese”

Pas njoftimit për nominimin e menaxherit të projektit kanë filluar aktivitetet e para drejt implementimit të këtij projekti. Është nënshkruar plani i menaxhimit të kontratës dhe është realizuar një takim me kontraktorin (Leonardo) në hapsirat e ASHNA-s. Në takim janë diskutuar disa detale rreth planit të implementimit të projektit, kurse nga pala kontraktuese është bërë një ekzaminim i sistemit dhe janë marrë versionet e softwerit ekzistues të ATM-it (CWP-ve, RCMS-it, FDP-ve etj.).

Me qëllim të implementimit sa më efikas të projektit, është mbajtur një takim pune me personelin udhëheqës të ATC-së, ku është diskutuar rreth implementimit të projektit “Rilokimi APP dhe TWR”, nga hapsira sisteme të vjetër në hapsirën e sistemeve të reja. Kontraktori “LEONARDO” bazuar në kontratën “APP/TWR Relocation and upgrade” përpos pozicionit të rilokimit, do të furnizojë me tri PC DS15 (CWP pa Barco monitor) dhe 4 kliente të ri FDPsë.

Vlen të theksohet se funksionalizimi i plotë i FDPsë, nuk mund të bëhet sepse me këtë kontratë, nuk është përfshirë “upgrade” i FDP për pranimin e mesazheve të FPL 2012. Sistemi i AFTN është azhuruar vite më parë, për pranimin dhe distribuimin e FPL 2012, por sistemi aktual i FDP nuk e njeh formatin e ri të këtyre mesazheve, dhe i refuzon si të panjohura. Për pranimin e këtyre mesazheve në këtë format të ri (FPL 2012), duhet që sistemi i FDP të adaptohet si nga pikepamja “Hardwer”ike poashtu edhe nga ajo “software”ike, që me këtë kontratë nuk është e paraparë. Prandaj funksionalizimi i FDPsë mbetet i njëjtë ashtu siq edhe është aktualisht.

Pas një periudhe, përsëri është mbajtur takim me kontraktorin ku është bërë revidimi kritik i dizajnit dhe janë precizuar datat konkrete se si do të procedohet tutje.

Në shtator, nga kompania kontraktuese Leonardo jemi njoftuar se po punojnë në implementimin dhe testimin e sistemit në fabrikë. Sipas parashikimeve, liferimi dhe instalimi i sistemit ishin parashikuar që të bëheshin në shtator. Kompania implementuese “Leonardo” ka përfunduar pjesën e infrastrukturës. Poashtu, ka dërguar edhe hardverin e nevojshëm për implementimin e projektit. Porse, e tërë dërgesa është bllokuar tek autoritetet doganore të Kosovës duke pritur për përfundimin e procedurave. Përgjegjësia e zhdoganimit të mallit është e kontraktorit.



Vizita në kompanitë prodhuese

Gjatë vitit 2019 ka patur disa vizita në kompanitë prodhuese në lokacionet e tyre, por edhe vizita nga kompanitë prodhuese në ASHNA, me qëllim të prezentimit të sistemeve me interes për të ardhmën e ASHNA-së.

Menaxheri i departamentit teknik së bashku me menaxherët e departamenteve ATC dhe QSSD, si dhe me zëvendës drejtorin për çështje operative kanë qenë në vizitë tek disa kompani prodhuese të sistemeve të aviacionit. Vizitat janë kryer në ERA, Leonardo dhe ENAV. Gjatë vizitave, përpos prezetimeve të produkteve të tyre ATM, AIM, MLAT, FDPS, PSR, janë prezentu edhe sistemet reale veç të prodhuara. Vlen të theksohet se vizitat me karakter të ngjashëm janë bërë edhe në të kaluarën tek ADACEL dhe Intelcan, si dhe tek SKYSYS. Këto vizita janë bërë si alternative e vizitave në panairin e ATCS në Madrid në të cilin (për arsye politike) kemi probleme që të marrim pjesë.

Shërbime konsulence për Sistemin e Menaxhimit të Trafikut Ajror dhe AIM


Para se të inicohet projekti për sistemin e ri ATM dhe AIM, është vendosur që të draftohen specifikacionet teknike me ndihmën e ekspertëve. Për këtë qëllim është angazhuar një kompani austriake (APAC) me të cilën është nënshkruar kontratë. Projekti ka zgjatë katër muaj dhe ka qenë i udhëhequr nga departamenti i ATC. DTEK ka qenë e përfshirë në projekt gjatë tërë kohës së implementimit. Në fund janë draftuar specifikacionet teknike për sistemet ATM dhe AIS to AIM me të cilat do të inicohen këto dy projekte madhore në vitin 2020.

METEO

Në baza mujore është përgatitur tabela klimatologjike e bazuar në METAR raportet dhe ditarin klimatologjik.

Këtë vit, në aspektin meteorologjik nga matjet e bëra në stacionin tonë meteorologjik rezulton se kemi pasur një vitë me reshje nën mesataren vjetore prej 540.7 l/m². Mesatarja vjetore e temperaturës prej 11.9°C ishte më e lartë në krahasim me mesataren e periudhës 2003-2019 prej 11.1°C. Ky edhe ishte viti me temperaturën mesatare më të lartë deri më tani të matur tek ne.

Për më tepër shih raportin e përmbledhur klimatologjik për vitin 2019, si në vijim:





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Viti - Year - 2019

Nr. i ditëve me Nr. of days with	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vj-An
FG	3	0	0	0	2	3	0	0	3	3	7	7	28
FZFG	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5	16
TS	0	0	0	1	2	11	7	6	3	1	0	0	31
GR - GS	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Reshjet Precipitations	23	9	4	12	15	9	8	5	7	4	18	12	126
Rrebeshet Showers	0	1	1	5	9	7	5	5	4	1	0	1	39
Reshjet - FZ Precipitations FZ	18	6	2	0	0	0	0	0	0	0	0	5	31
Era Wind => 15kT	9	16	24	22	19	8	13	8	9	10	13	12	163
Era Wind => 20kT	4	9	12	8	7	0	2	4	3	5	7	5	66
Era Wind => 25kT	0	6	4	3	2	0	0	1	0	0	3	1	20
Era Wind => 30kT	0	1	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	3

Numri i ditëve me disa prej fenomeneve të paraqitura sipas muajve dhe vitit 2019
The number of days with some of phenomena appearance by months and year 2019

Temperaturat gjatë vitit 2019 dhe numri i ditëve me temp. në (°C)


Temperature during the year 2019 and number of days with Temp. in (°C)

Temperature during the year 2019 and number of days with Temp. in (°C)								Nr. i ditëve me: - Nr. of days with:								
Muajt-Months	Nr. dt.-day	Tmax	<Tmax>	Tmin	<Tmin>	<T>	<T>*	T<= -20	T<= -15	T<= -10	T<= -5	T<= 0	T>= 20	T>= 25	T>= 30	T>= 35
Janar - January	31	8.2	1.1	-15.3	-6.9	-2.6	-2.6	0	2	10	19	29	0	0	0	0
Shkurt - February	28	15.8	7.8	-11.0	-2.7	2.6	2.8	0	0	1	9	21	0	0	0	0
Mars - March	31	23.5	15.4	-5.5	0.9	8.4	8.6	0	0	0	1	14	3	0	0	0
Prill - April	30	27.2	17.5	-0.4	5.7	11.6	12.0	0	0	0	0	1	6	2	0	0
Maj - May	31	24.9	19.2	3.1	7.8	13.6	13.9	0	0	0	0	0	12	0	0	0
Qershor - June	30	32.5	27.2	11.0	14.8	20.9	21.2	0	0	0	0	0	28	24	7	0
Korrik - July	31	36.1	28.5	7.9	14.1	21.6	21.9	0	0	0	0	0	31	25	13	1
Gusht - August	31	36.3	31.1	9.6	14.6	22.9	23.2	0	0	0	0	0	31	28	22	2
Shtator - September	30	31.6	24.8	1.4	10.5	17.6	17.9	0	0	0	0	0	27	18	3	0
Tetor - October	31	26.6	22.3	0.8	5.1	13.1	13.2	0	0	0	0	0	24	9	0	0
Nëntor - November	30	21.4	14.9	-0.9	5.2	10.1	10.1	0	0	0	0	2	2	0	0	0
Dhjetor - December	31	14.8	6.1	-7.6	-0.5	2.7	2.7	0	0	0	3	17	0	0	0	0
Viti - Year	365	36.3	18.0	-15.3	5.7	11.9	12.1	0	2	11	32	84	164	106	45	3

Në afatin e paraparë, para përfundimit të muajve, sipas manualit janë përgaditur dosjet mujore nga të dhënat e disponueshme 2003 – 2018, për parametrat signifikant të motit që mund të reflektojnë në operativitetin e punës për muajt vijues dhe konsiderohen si një udhërrëfyes për parashikimet e motit.

Nga raportimet e rregullta nga Divizioni i Parashikimit në vitin 2019 shprehur në përqindje, 99.30% (99.57% në vitin 2018) të produkteve dhe raporteve janë dërguar në kohën e paraparë.

Parashikimi	Raporte / produkte të dërguara në total	Raporte/produkte të dërguara me vonesë kohore				Të padërguara
		TAF	LAF AM/LAF PM	CROSS SECTION	7 DAY FORECAST	
Periudha						
2019	3609	10	5	3	5	2
2019	Aerodrome Warnings	Weather Warnings		TAF AMD	LAF AMD	MOR
	227	209		222	9	27



Në vitin 2019 në Divizionin e Vrojtimit kemi pasur 17494 raporte të rregullta meteorologjike si dhe 119 raporte të dërguara si SPECI. Prandaj numri i të gjitha raporteve në vitin 2019 duke i përfshirë edhe 119 raportet SPECI si dhe 26 raportet e padërguara arrinë në 17639. Në vitin 2019 numri i raporteve të dërguara arrinë shifrën e llogaritur në përqindje 99.85% ose 0.15% e raporteve të padërguara nga shuma totale.

Përkundër problemeve teknike të gjitha raportet meteorologjike janë dërguar duke ju falënderuar edhe sistemeve alternative që disponojmë.

Vrojtimi	Raporte të dërguara METAR dhe SPECI	Raporte të padërguara METAR	Raporte të dërguara me vonesë	Raporte të dërguara me metoda alternative shkaku i problemeve teknike
Periudha				
2019	17639	26	0	12



PERSONELI

ASHNA burimet njerëzore i sheh si elementin kyç për të mundësuar zbatimin e vizionit të vet për t'u bërë një ofrues i sigurtë i shërbimeve të navigimit ajror me efikasitetin më të lartë të koston në rajon. Personeli i përgjithshëm gjatë vitit 2019 në ASHNA është 180.

Ndarja e personelit sipas njësisë organizative

Nr.	Njësia organizative	Numri i personelit
1	Zyra e Drejtorit	12
2	Departamenti për Zhvillim dhe Trajnim	2
3	Departamenti i Shërbimeve të Trafikut Ajror	37
4	Departamenti i Shërbimeve të Informacionit Aeronautik	17
5	Departamenti i Meteorologjisë	16
6	Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim	21
7	Departamenti Teknik	43
8	Departamenti i Burimeve Njerëzore	6
9	Departamenti i Financave	10
10	Departamenti i Prokurimit	4
11	Departamenti i Administratës	10
12	Departamenti Ligjor	2
Numri i përgjithshëm		180

Ndarja e personelit sipas gjinisë

Nr.	Gjinisë	Numri i personelit
1	Femra	33
2	Meshkuj	147
Numri i përgjithshëm		180

Ndarja e personelit sipas moshës

Nr.	Mosha	Numri i personelit
1	18-30	40
2	31-40	77
3	41-50	51
4	51-65	12
Numri i përgjithshëm		180

Departamenti i Burimeve Njerëzore, duke respektuar ligjet, rregulloret dhe procedurat e Shërbimit Civil të Kosovës, gjatë periudhës Janar – Dhjetor, 2018 ka qenë e përkushtuar që kërkesave të njësive organizative ti përgjigjet dhe t'i sigurojë mbështetje në aspektin e burimeve njerëzore në – rrjedhimisht të sigurojë përmbushjen e planit të personelit. Gjatë periudhës raportuese, ASHNA ka zhvilluar këto aktivitete të rekrutimit dhe selektimit:

Numri referues		Titulli i pozitës së punës	Lloji i konkursit	Statusi
ASHNA-REK-001-2019	1	Mbikëqyrës i ndërrimit Kullë / Vajtje - Ardhje	I brendshëm	Plotësuar
ASHNA-REK-002-2019	1	Udhëheqës i divizionit të parashikimit	I brendshëm	Plotësuar
ASHNA-REK-003-2019	1	Teknik Udhëheqës i Ndërrimit i KOM&MET	I brendshëm	Plotësuar
ASHNA-REK-004-2019	1	Teknik Udhëheqës i Ndërrimit të Sistemit të Navigimit	I brendshëm	Anuluar
ASHNA-REK-005-2019	1	Teknik Udhëheqës i Ndërrimit të Sistemit të Survejimit	I brendshëm	Anuluar
ASHNA-REK-006-2019	12	Student Kontrollor i Trafikut Ajror	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-007-2019	2	Inxhinier i Divizionit të Komunikimeve	I jashtëm	Anuluar
ASHNA-REK-008-2019	1	Inxhinier i Divizionit të Navigimit	I jashtëm	Anuluar
ASHNA-REK-009-2019	2	Inxhinier i Divizionit të Survejimit	I jashtëm	Anuluar
ASHNA-REK-010-2019	1	Zyrtar i Depos	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-011-2019	1	Asistent Ekzekutiv	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-012-2018	1	Arkivist	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-013-2018	1	Udhëheqës i Sektorit të Pasurisë	I brendshëm	Plotësuar
ASHNA-REK-014-2018	1	Udhëheqës i Sektorit të Shërbimeve të Përbashkëta	I brendshëm	Plotësuar
ASHNA-REK-015-2018	2	Inxhinier i Divizionit të Komunikimeve	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-016-2018	1	Inxhinier i Divizionit të Navigimit	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-017-2018	2	Inxhinier i Divizionit të Survejimit	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-018-2018	1	Ekspert i Aviacionit	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-019-2018	1	Zyrtar për Tarifa	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-020-2018	1	Zyrtar i Arkivës	I jashtëm	Plotësuar
ASHNA-REK-021-2018	1	Menaxher i Departamentit të Burimeve Njerëzore	I brendshëm	Plotësuar
ASHNA-REK-022-2018	1	Auditor i Brendshëm	I jashtëm	Plotësuar

Kontrollet sistematike për personelin e ASHNA-së

Duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-2016 për Siguri dhe Shëndet në punë, përkatësisht nenin 22, paragrafi 2, sipas të cilit “Punëdhënësi është i detyruar t’i dërgoj në kontrolla mjekësore të gjithë të punësuarit së paku një herë në tre(3) vite”. - ASHNA me qëllim të preventivës, dhe duke pas parasysh rëndësinë e madhe të zbulimit të hershëm të sëmundjeve dhe problemeve shëndetësore, ndikimin e tyre në mirëqenien fizike, psikike dhe sociale të punëtorëve, ka organizuar kontrollat sistematike shëndetësore për gjithë personelin në vitin 2018, andaj pritet që kontrolla e ardhshme të realizohet jo më vonë se në vitin 2021.

Gjatë vitit 2019, Divizioni për Siguri dhe Shëndet në punë, përmes metodologjisë profesionale ka përcjellë gjendjen shëndetësore të personelit.

Vlerësimi i riskut në vendin e punës

Në mbështetje të Ligjit Nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, ASHNA në vitin 2018 ka finalizuar Raportin mbi vlerësimi e riskut në vendin e punës, i njëjti është rishikuar dhe përditësuar në vitin 2019 bazuar në vlerësimet profesionale, me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, si preventivë ndaj aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale, marrjes së masave mbrojtëse dhe sigurimin e pajisjeve personale mbrojtëse sipas profesioneve.



TRAJNIMET

Aktivitetet e DZHT-së kanë qenë të ndërlidhura kryesisht në fushën e trajnimit dhe avancimit të stafit me qëllim të mbajtjes së nivelit të kompetencës në pikën e dëshiruar, pa përjashtuar edhe zhvillimin e ASHNA-së si objektiv kryesor.

Në pjesën e aktiviteteve dhe projekteve janë përfshirë aranzhimet, përgatitjet, realizimet dhe rezultatet e projekteve të ndryshme që kryesisht janë kompetencë e DZHT-së.

Në kuadër të detyrave dhe funksioneve të paracaktuara, DZHT raporton mbi mbarëvajtjen dhe zhvillimin e proceseve të departamentit pranë ASHNA-së për vitin 2019.

Gjatë periudhës raportuese të vitit 2019, DZHT ka kryer detyrat e veta në pajtim me Planin operativ të punës, Planin e trajnimeve dhe me detyrat e përcaktuara në manualin e DZHT-së. Në këtë mënyrë DZHT ka siguruar shërbim cilësor në përputhje me normat e aplikueshme, me qëllim që të sigurohet mbajtja e kompetencës profesionale për të gjitha njësitë e ASHNA-së.

Për trajnimin e stafit administrativo financiar kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyer me institucionet vendore siç janë IKAP, AUK, AKSP, LIMAK, ADA Consulting, FLSA, LMC & ITA etj.

Gjatë kësaj periudhe për realizimin e trajnimeve janë lidhur kontrata bashkëpunimi me organizata trajnuese ndërkombëtare për trajnim të stafit operativ dhe jo vetëm, siç janë: Eurocontrol, Global ATS nga Danimarka, Leonardo nga Italia, CANI nga Republika Çeke.

Trajnimet në vitin 2019, janë realizuar në pajtim me planin e trajnimeve dhe me kërkesat e domosdoshme që kanë ardhë si rezultat i procesit të zhvillimit të institucionit dhe të avancimit të stafit

Gjatë vitit 2019, personeli i ASHNA është aftësuar në shumë fusha, por trajnimet që vlenë tu ipet theks i veçantë janë:

Trajnimi Refresh për KTA dhe Trajnimi Refresh për OJTI

Gjatë kësaj periudhe raportuese, DZHT përmes Akademisë së Aviacionit Civil të Republikës Çeke – CANI organizoi dhe realizoi trajnimin freskues të njohurive për kontrollor të trafikut ajror për gjithë kontrollorët e trafikut ajror të ASHNA-së për njësinë e Vajtje/Ardhjeve me ndarje mes fluturakeve duke shfrytëzuar radarin dhe kriteret procedurale të ndarjes ky trajnim që është në përputhje me kërkesat ligjore sipas rregullores të KCAA-së me numër 19/2017. Përveç këtij trajnimi, gjatë kësaj periudhe u organizua përmes të njëjtit institucion

edhe trajnimi rifreskues i njohurive për instruktor të trajnimit në vend të punës për profesionin e kontrollorit të trafikut ajror.

Në këtë mënyrë, ASHNA arriti që të përmbushë kërkesat që dalin nga rregullorja 19/2017 e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, përmes të cilës janë transponduar dispozitat e Rregullores 2015/340 të Komisionit Evropian.

Organizimi i kursit ATSEP Qualification për personelin Teknik

Përgjatë kësaj periudhe raportuese është organizuar dhe realizuar trajnimi i personelit teknik në ATSEP qualification me Institutin Çek të navigimit CANI.

Ky trajnim ka pasur për qëllim ngritjen e kapaciteteve njerëzore në fushen operative.

Trajnimi i student Kontrollorëve të trafikut ajror


Përgjatë kësaj periudhe raportuese DZHT-j ka asistuar dhe më pas kanë filluar trajnimin student kontrollorët e trafikut ajror nga ASHNA në Republikën Çeke ku kanë vijuar trajnimin dymbëdhjet student kontrollor trajnimin bazik dhe më vonë janë ndarë në dy grupe dhe kanë vijuar trajnimin për Gradime në TWR dhe APS. Grupi i parë është kthyer nga trajnimi i gradimit TWR në gjysmën e parë të muajit Dhjetor ndërsa grupi i dytë i gradimit APS ka përfunduar trajnimin në gjysmën e dytë të muajit Dhjetor.

Trajnimi për “Aeronautical Information Service Personnel”

Përgjatë kësaj periudhe raportuese është kontraktuar dhe realizuar trajnimi për trajnimin e 20 zyrtarëve të AIS të ndarë në dy grupe. Një grup nga personeli i është nënshtruar trajnimit nga data 18 Nëntor deri më 13 Dhjetor derisa për grupin e dytë do të caktohet data në fillim të vitit të ardhshëm.

Gjatë vitit kemi freskuar data bazën e trajnimeve të mbajtura, ku kemi 9494 orë trajnuese në total. Orët trajnuese i kemi klasifikuar si ore trajnuese për stafin operativ dhe administrativ, si dhe orë trajnuese sipas vendit të mbajtjes së trajnimit, si në vijim.

Në grafik mund të gjeni orët trajnuese të ndara për stafin operativ dhe administrative.



Gjithesëjt kanë qenë 9494 orë trajnuese , ku për stafin operativ janë mbajtur 7272 apo 76.6% ndërsa për stafin administrative janë mbajtur 2222 apo 23.4 %

Në vijim, po paraqesim në formë tabelare të gjitha trajnimet e mbajtura gjatë vitit 2019.

Nr	Trajnimi	Numri i personelit	Departamenti	Instituci-oni
1	X-Ray Control	Personeli i sigurimit	DCSS	MPB LIMAK
2	Përdorimi i mjeteve themelore gjatë shuarjes së zjarrit	16	ASHNA	AKSP /AME
3	Menaxhimi i performances	3	ASHNA	IKAP
4	Planifikimi dhe menaxhimi i projekteve me MS Project	4	ASHNA	IKAP
5	Trajnimi Themelor I personelit te sigurimit mbi aviacionin	6	ASHNA	ASHNA
6	Data Procesing	1	DTEK	IANs Eurocontroll
7	Auditimi i Burimeve Njerëzore	1	ASHNA	IKAP
8	„Hartimi i Legjislacionit	3	ASHNA	IKAP
9	Trajnim i përgjithshëm për BE dhe Kosova në procesin e Integrimit Evropian	1	ASHNA	IKAP

10	Legjislacioni i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës/Procedurat Disiplinore dhe Procedurat e Ankesave në Shërbimin Civil”	8	ASHNA	ADA Consulting
11	Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin e Dokumenteve	2	ASHNA	IKAP
12	Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin e Dokumenteve	2	ASHNA	IKAP
13	Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin e Dokumenteve	2	ASHNA	IKAP
14	Microsoft Access 2013	5	ASHNA	IKAP
15	Menaxhimi i Projekteve	7	ASHNA	IKAP
16	Planifikimi dhe vendimmarrja	5	ASHNA	IKAP
17	Kodi Etik, të drejtat dhe përgjegjësitë në Shërbimin Civil	2	ASHNA	IKAP
18	Menaxhimi Parasë Publike dhe Rregullat Financiare	6	DFIN	ADA Consulting
19	Trajnim i përgjithshëm për BE dhe Kosova në procesin e Integritetit Evropian	2	ASHNA	IKAP
